



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

27.05.2019

01-060/01-570



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -V-, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë **03.06.2019, (e Hënë)**, duke filluar në ora 09:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë në Shtëpinë e Kulturës. "Gursel e Bajram-Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e rregullt e KK-Vitisë
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme të komunës në shfrytëzim.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave në Komunën e Vitisë.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar të rënët Hajrulla e Saqip Tërpeza
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit të Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit vendimi nr. 01-410/03-129 i datës 28.02.2019.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozim rregulloren për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimi të objekteve dhe fushave sportive publike
7. Informatë (raport) mbi punën e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
8. Informatë për Manifestimin Flakadani i Karadakut edicioni XVIII
9. Informatë, mbi përgatitjen për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të Komunës së Vitisë për sezonin veror.
10. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për periudhën janar-prill 2019.

Viti, më 27.05.2019

Kryesuesi i Kuvendit
Najm Pira





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008, nenit 17 pika 2 lidhur me piken 6 të Ligjit për dhënjën e pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim nr.06/L-092 dhe neni 10 paragrafi 2 pika i lidhur me nenin 50 pika 1, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me datën 13.05.2019 bën këtë :

15.05.2019

PROPOZIM VENDIM 02-035/02-527

PËR formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënjën e pronës palujtshme të komunës në shfrytëzim

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim, propozohet të : Formohet Komisioni për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim të komunës së Vitisë. Komisioni propozohet pre 5 anëtarëve , dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunës dhe një nga shoqëria civile dhe at:

- Fadil Hoxha- anëtar i komisionit- Drejtoria e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë
- Shefki Aliu- anëtar i komisionit – Drejtoria e Financave
-
-
-

Neni 2.

Me këtë propozim- vendim , detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për dhënjën në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr.10, të datës 03.04.2019). Komisioni vlerësues udhëheq me procedurat mbi dhënjën e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim si : përgatit kriteret e ankandit , përcakton çmimin fillestar , vlerëson ofertat dhe ja propozon kuvendit oferte më të favorshme. Njësit përkatse të administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës , Drejtoria për Kadaster , Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike e komunës së Vitisë.

Neni 6.

Me këtë vendim propozohet të shfuqizohet Vendimi për Formimin Komisioni për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës me nr.01-410/0356, të datës 02.02.2018.

Neni 7.

Ky Vendim propozohet të fuqizohet në ditën e miratimit në Kuvendin Komunal të Vitisë.

Drejtori:
Majlinda Ostroglava



Kryetari i Komunës:
Sokol Haxhiu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

02.02.2018

01-410/CB-56

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d), neni 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) neni 8, pika 2 e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, neni 10 paragrafi 2 pika i), lidhur me nenin 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013-491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.01.2018, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e komisioni për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Vitisë. Komisioni ka 7 (shtatë) anëtarë, tre nga ekzekutivi, tre nga Kuvendi i Komunës dhe një nga Shoqëria civile, dhe atë:

1. Hidajete Aliu (anëtare e komisionit – Juriste),
2. Tajar Neziri (anëtar i komisionit – Gjeodet),
3. Myfajl Azizi (anëtar i komisionit – Ekonomist),
4. Rufadije Halimi-Rexhepi (anëtare e komisionit - anëtare e Kuvendit),
5. Reinzi Salihu (anëtar i komisionit - anëtar i Kuvendit),
6. Samet Idrizi (anëtar i komisionit - anëtar i Kuvendit), dhe
7. Tefik Salihu (anëtar i komisionit nga shoqëria civile)

Neni 2

Detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë të përcaktuara në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores QRK Nr.23/2015, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës. Komisioni vlerësues udhëheqë me procedurat mbi dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim si: përgatitë kriteret e ankandit, përcakton çmimin fillestar, vlerëson ofertat dhe ja propozon Kuvendit ofertën më të favorshme. Njësitë përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit; Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi; Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyrë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008), neni 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrative të akteve të komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Kadastër,
3. Drejtoria për Shërbime Publike, dhe
4. Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Naif Pira



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe 50 paragrafi 1 shkronja l, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me datën 15.05.2019 bën këtë :

16.05.2019

02-035/02-535

PROPOZIM VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE KUSHTUAR TË RËNET HAJRULLA E SAQIP TERPEZA

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim , propozohet të vendoset pllaka përkujtimore për të rënet e Hajrullah e Saqip Terpeza në fsh. Terpeze , sipas kërkesës së Këshillit kordinus të fshatit Terpezë me nr.02-320/04-50610, të datës 18.10.2018.

Neni 2.

Me këtë propozim- vendim , lokacionin për vendosjen e pllakës kushtuar të rëneve Hajrullah dhe Saqip Terpeza nga fsh. Terpeze, komuna e Vitisë , sipërfaqen prej 0.50 m² që shtrihet në pjesen e parcelës kadastrale 1265-2, Zona Kadastrale Terpezë në pronësi të P.Sh. Komuna e Vitise- Viti.

Neni 3.

Ky propozim –vendim paraqet bazë për lejin e vendosjes së kësaj pllake përkujtimor.

Neni 4.

Pjesë përbërse të këtij propozim –vendimi është : fleta poseduese , kopja planit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës , Drejtoria për Kadaster , Pronë dhe Gjeodezi,e komunës së Vitisë.

Neni 6.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Drejtori:
Majlinda Ostrogllava

Kryetari i Komunës;
Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MIEDIST DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101005-01265-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	717/2019
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	15.05.2019 - 11:06
Komuna / Opština / Municipality:	Viti / Vitina / Viti
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone:	TERPEZE / TRPEZA / TERPEZE
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office:	Viti / Vitina / Viti

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan	Azhuruar Azurirano Updated
P-70101005-01265-2	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore/ Društvena Imovina / Socially owned Land		5333			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan	Azhuruar Azurirano Updated
ESHAT/ESHAT/ESHAT		ESHAT		

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numeri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Supërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Shërbimet Publike/Javne Usluge/Public Services	Vareze/Grabiye/cemetery		5333

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësi e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseçtim individual / Individualna Drzavina / single possessor	P.SH. KOMUNA VITI-- VITI	KCID914109320	VITI / VITINA / VITI /			1/1		



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Viti

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 1265-2

Zona kadastrale / Katastarska zona: Tërpeze

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000

Koordinatat e parces se projektuar		
Nr.	Y	X
1	7528344.408	4695353.301
2	7528342.870	4695359.584
3	7528335.567	4695358.325
4	7528336.937	4695351.633

Skica e smadhuar

~~1265-2~~

1265-4

1265-5
50m²

Gjatë lëvizës e rrugës
se anësore

Rruga Kryesore e Fshatit

~~1265-2~~

1265-4

1265-5
50m²

Rruga Kryesore e Fshatit

Rilevoi / Snimio: Reis Bajrami

(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ emri i prezime gjeodeta/ kompanisë)

Nr. i licencës / Br. licence: ZKK-Viti

Nënshkrimi / Potpis: _____





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti

15-05-2019

11-070/01-530

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

11-Nr.

13/12/2018

Për	z. Majlinda Ostrigllava, Drejtoreshë në D.GJ.K.P. – Komuna e Vitisë
Lëda	Dhënje e informatës
Nga	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Viti

Të nderuar,

Pas kërkesës suaj të bërë në Drejtorinë tonë e cila mbanë datën 06.12.2018, me numër protokoli 07-070/01-1291, për dhënjen e informatave lidhur me parcelën numër 1265-2, e, Zona Kadastrale e fshatit Tërpezë, Komuna e Vitisë. Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ju informon se parcela e lartëshënuar sipas Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë dhe Klllokotit kjo parcelat me numër numër 1265-2 është në kuadër të kufinjve ndërtimor të banimit të fshatit Tërpezë.

Vërejtje: Ky dokument shërben vetëm për informim se çka parasheh PZHK, ndersa për çdo veprimë në këto zona duhet paisur me leje përkatëse nga organet kompetente nëse është subjekt i lejeve të cilat kërkohen sipas ligjlacionit në fuqi.

Me respekt.

Drejtori:

Ajet Sallahu/



Më: 13.12.2018

REPUBLIKË E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
18-10-2018
Vlera
Vrednos
02-320/04-50610



ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS
E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS
Dega në VITI



KOMUNA E VITISË
KRYETARIT KOMUNËS

Lënda :

K Ë R K E S Ë

Kërkojmë nga titulli i lartëpërmendur, që të mundësoj shfrytëzimin e parcellës nr.01265-2, P-70101005-01265-2 në sipërfaqe prej 150 m2.

Parcela nevojitet për ndërtimin e një pllake përkujtimore për vllazërit HAJRULLAH e SAQIP Tërpeza.

Saqip Tërpeza është ekzekutuar në masakrën e Gjilanit me 07 Janar 1946.

Hajrullah Tërpeza pas luftës së dytë botërore e deri në vdekje më 22.10.1982 veproi në emigracion për lirinë e kombit dhe Shqiprinë Etnike.

Për shkak kontributin për çështjen kombëtare Hajrullah Tërpeza nga Presidenti I Shqipërisë Ilir Meta u dekorua me urdhërin " Kalors I Skënderbeut "

Ne si OVL e UÇK dega në Viti çmoj sakrificën për liri e atdhe të vëllezërve Saqip e Hajrullah Tërpeza.

Mbesim me shpresë se kërkesa jonë do të realizohet.

Viti 09.12.2016.

Kryetari i degës së OVL së UÇK-së

Abdy Bajrami
[Signature]

DATA	18-102018
REFERENCAË,	
PËR	Drejtorinë për Kadastër ,Pronë dhe Gjeodezi-Viti
CC.	z.Sokol Haliti ,Kryetar I Komunës së Vitisë
PËRMES,	Arhives komunale ,viti
NGA	Këshilli lokal i fshatit Tërpezë ,Selami Rexhepi
TEMA	Kërkesë

Kërkojm që të na lejohet shfrytzimi I parcellës kadastrale me Nr 01265-2 Tërpezë me siperfaqe prej 150m.

Kjoi sipërfaqe kërkohet për ndërtimin e pllakave përkujtimore për vllëzrit **Hajrulla dhe Saqip Tërpeza** .

Për ndërtimin dhe rregullimin e pllakave përkujtimore për vllëzrit **Hajrulla dhe Saqip Tërpeza** është përkrahur nga këshilli i fshatit ,banorët e fshatit ,lagjësja dhe nga mbështetja e Organizatës së Veteranëve të luftës në Viti.

Me respektin ,që kerkesa jonë të shqyrtohet dhe të aprovohet duke respektuar iniciativën e lartëshënuar .

Numri kontaktus

Nr.044-477- 522

Ushtruesit e kërkesës .

Këshilli Lokal I fshatit Tërpezë

Selami Rexhepi

N. P.



1005509650



PROJEKTI I PLLAKAVE PËRKUJTIMORE
PËR VLLËZËRIT

“HAJRULLA DHE SAQIP TËRPEZA”
FSHATI TËRPEZ

PARAMASA ME PARALLOGARI

Hartoi :


Nevzat Tërzimng cil.

PARAMASA ME PARALLOGARI

NDËRTIMI I PLLAKAVE PËRKUJTIMORE PËR VLLËZËRIT

"HAJRULLA DHE SAQIP TËRPEZA"

FSHATI TËRPEZË-KOMUNA VITI

Nr.	Pozicioni	Njesia	Sasia	Çmimi njesi	Çmimi total
				€	€
1	PUNISHTJA				
1.1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË PUNISHTË				
1.1.1	Shenimi i pikave geodezike si dhe percjellja e punimeve ne teren gjate ekzekutimit.	m²	144.45	10.00	1,444.50
				Gjithsej 1.1:	1,444.50
1.2	PASTRIMI I TERENIT				
1.2.1	Largimi i materialit ekzistues me ngarkim dhe transport deri në deponi në largësi 2-5km.	m²	144.45	1.20	173.34
				Gjithsej 1.2:	173.34
1.3	PUNËT TOKËSORE				
1.3.1	Germimi i humusit t=30 cm me deponim jashte punishtës	m²	43.00	1.20	51.60
1.3.2	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës me ngjeshmeri 40MN/m²	m²	144.45	1.00	144.45
1.3.3	Vendosja e dheut në parkë , mbushje me ngjeshje, plantifikim dhe gjelbërim me trashësi t=20cm	m²	49.70	1.80	89.46
1.3.4	Mbjellja e barit në shiritat e parkut .	m²	99.40	1.00	99.40
1.3.5	Ndertimi i parkut me kocka tip Parket .	m²	60.00	19.00	1,140.00
				Gjithsej 1.3:	1,524.91
1.4	PUNËT E TAMPONIT				
1.4.1	Punimi i tamponit me ngjeshje (50MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=25cm	m²	15.00	15.00	225.00
				Gjithsej 1.4:	225.00
1.5	PUNIMI I KONSTRUKSIONIT TË PLLAKAVE PËRKUJTIMORE NGA BETONI I ARMUAR				
1.5.1	Punët e betonit ndahen në 5 hapësira dhe ndërtohet nga betoni i armuar Dimensionet: B x L ≈8.25 m' x 15.47 Në çmim të llogariten këto punime:				
1.5.2	Punët e betonit të armuar				
1.5.2.1	Beton i varfër, t=10cm - C-12/13 , (nën themele)	m³	7.00	50.00	350.00
1.5.2.2	Fondamenti , t= 30cm -C 30/37 . (Me Aditiv Hiperplastifikator)	m³	11.00	65.00	715.00
1.5.2.3	Pilaka finale, t=30cm - C 35/45 , (Me Aditiv Hiperplastifikator)	m³	9.00	70.00	630.00
1.5.2.4	Muri ballor , t=30cm - C 30/37 , (Me Aditiv Hiperplastifikator)	m³	5.00	65.00	325.00
1.5.2.5	Pilaka e pjerrët e murit ballor , t=25cm - C 30/37 (Me Aditiv Hiperplastifikator)	m³	3.00	65.00	195.00
1.5.2.6	Muri kufizues i objektit, t=25cm - C 30/37 (Me Aditiv Hiperplastifikator)	m³	20.00	65.00	1,300.00
				Gjithsej 1.5:	3,515.00
1.6	Punët e mermerit me mbishkrime		m²	100.00	40.00
				Gjithsej 1.6:	4,000.00
				G J I T H S E J :	10,882.75 €


Hartoi:

Nezhat Tërziq mng.cil.

VËREJTJE:

1. Punimet duhet të mbikqyren nga hartuesi - përpiluesi i projektit.
2. Të gjitha pozicionet të realizohen duke respektuar përshkrimin teknik.

Sketch






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na



Në bazë të nenit 58 shkronja h) Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 50 shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-129, të datës 28.02.2018, të Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që të bënë ndryshim plotësimin e vendimit nr.01-410/03-129, të datës 28.02.2018, të Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit

Neni 2.

Konform nenit 1 të këtij propozim vendimi, Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit duhet të ndryshohet dhe të plotësohet, ku nenin 2 i vendimit nr.01-410/03-129, të datës 28.02.2018 anëtarin me numër rendor 1. znj. RUFADIJE Rexhepi zëvendësohet me _____

Neni 3.

Te gjitha pjesë tjera të vendimi nr.01-410/03-129, të datës 28.02.2018, Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit mbeten në fuqi.

Neni 4.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

Propozues:

Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VITISË - QI			
Pratvar - Prerapje Nr. 03/1		28-02-2018	
Nr. i organit Org. broj	Rumit/Broj	Shërbimi Prerapje	Vlera Vlerësim
01-410/03+129			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12 shkronja d, neni 40 paragrafi 2, shkronja e dhe neni 51 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, neni 36 shkronja d, neni 40,47 shkronja b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më datën 27.02.2018, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen të Mjedisit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Komiteti për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit ka 5 (pesë) anëtarë, dhe atë:

1. Rufadije Rexhepi, anëtarë e Kuvendit
2. Jakup Demiri, anëtar i Kuvendit
3. Faulani Haxhiu, anëtar i Kuvendit
4. Besim Ymeri, anëtar i Kuvendit
5. Shefkide Shabani, anëtarë nga shoqëria civile

Komitetit për planifikim, rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit, në mbledhjen e parë do ta zgjedh kryesuesin e këtij komiteti.

Neni 3

Komiteti nga neni 1 i këtij vendimi, ka për detyrë që të shqyrtoj çështje e planifikimit, rregullimit të hapësirës dhe mbrojtje të mjedisit dhe të jep vërejtje, propozime dhe sugjerime lidhur me planifikimin, rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e mjedisit për Komune e Vitisë.

Neni 4

Anëtarët Komitetit për planifikim, rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit, të emëruar në neni 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryesuesi i Kuvendit dhe kryesuesi i Komitetit.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Anëtarëve të Komitetit, dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Naim Pira

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opština Vitina – Municipality of Viti



08.05.2019
02-035/02-498

Në bazë të nenit 58, shkronja h e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 50.1, shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen në diskutim publik për propozim rregulloren për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve dhe fushave sportive publike

Neni 1

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpall në diskutim publik për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve dhe fushave sportive publike.

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i propozim rregullores për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve dhe fushave sportive publike, 26 qershor 2019.

Neni 3

Debat i publik do të mbahet me datën 26.06.2019, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik, është për të krijuar opinione pozitive për propozim rregulloren, realizimin, për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve dhe fushave sportive publike.

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:

Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opština Vitina – Municipality of Viti



PROPOZIM RREGULLORE
PËR
MËNYRËN E MENAXHIMIT DHE KUSHTET E
SHFRYTËZIMIT TË OBJEKTEVE SPORTIVE PUBLIKE

Viti, 08 maj 2019

Në bazë të nenit 58, shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 50.1, shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM RREGULLORE

**për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve
dhe fushave sportive publike**

Neni 1

Kjo rregullore, ka për qëllim rregullimin e mënyrës së menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve dhe fushave sportive publike, përjashtimisht objekteve sportive shkollore, duke ndarë përgjegjësitë: të drejtat, detyrimet, kompetencat, procedurat dhe kushtet e mirëmbajtjes për të gjitha palët të cilat janë të angazhuara për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe edukimin e të gjitha gjeneratave përmes sportit.

Neni 2

Objektivat

1. Kjo rregullore definon dhe rregullon çështjet:
 - a) Mënyrën e menaxhimit të objekteve sportive publike;
 - b) Funksioneve të hapësirave të objekteve sportive publike;
 - c) Të drejtën e shfrytëzimit të objekteve sportive publike;
 - d) Procedurat për marrjen në shfrytëzim të objekteve sportive publike;
 - e) Tarifat për shfrytëzimin e objekteve sportive publike;
 - f) Mirëmbajtjes së objekteve sportive publike;
 - g) Procedura për dëmet e shkaktuara;
 - h) Të drejtën dhe kushtet për vendosjen e reklamave statike dhe lëvizëse në objekte sportive publike; dhe
 - i) Rëndin shtëpiak në objektet sportive publike.

Neni 3

Përkufizime

1. "DKRS", nënkupton Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
2. "SS"- Sektori i Sportit;
3. "DF", nënkupton Drejtoria e Financave;
4. "PAT" - Personat me Aftësi të Kufizuara;
5. "Objekti Sportiv Publik", nënkupton objektin brenda dhe jashtë;
6. "Udhëheqësi i objektit sportiv publik", nënkupton personin zyrtar që kujdeset për planifikim dhe organizim të punëve, koordinimin me klubet, komunikimin me strukturat e komunës, kontrollin e stafit, raportimin e punës.

7. "Aktivitete Sportive" - nënkupton të gjitha organizimet nga personat fizik dhe juridik për zhvillimin e veprimtarive garuese-rekreative.
8. "Aktivitete josportive", nënkupton të gjitha organizimet nga personat fizik dhe juridik, për zhvillimin e aktiviteteve josportive.

Neni 4

Funksionet e objekteve sportive publike

1. Funksioni primar i objektit sportiv publik është realizimi i aktiviteteve sportive për shkollat e sporteve, shoqatat sportive, lidhjet sportive, klubet sportive si dhe organizatat që janë të regjistruara në organet përkatëse publike.
2. Funksioni sekondar i objektit sportiv publik është në funksion të ngjarjeve që nuk kanë karakter sportiv.
- 2.1. Aktivitetet josportive bëhen me kërkesë të veçanta dhe vetëm për ato aktivitete që nuk bien në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik.

Neni 5

E drejta e shfrytëzimit

1. Te drejtën për shfrytëzimin e objekteve sportive publike për aktivitete sportive dhe josportive e kanë personat fizik dhe juridik.
2. Shfrytëzuesit e objekteve sportive publike për aktivitete sportive parashtrojnë kërkesë dhe marrin pëlqim nga organi përgjegjës i DKRS-së.
3. Për te drejtën e shfrytëzimit të objekteve sportive publike për aktivitetet josportive përveç pëlqimit, merret edhe vendimi nga DKRS.

Neni 6

Menaxhimi i objekteve sportive publike

1. Përgjegjës për menaxhimin e objekteve sportive publike është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport/Spektori për Sport në kuadër të DKRS-së.
2. Për organizimin e brendshëm strukturor vendos Kryetari i Komunës së Vitisë, me rekomandimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Zyrtarëve përgjegjës të objekteve sportive publike nuk u lejohej pa vendimin e organeve përgjegjëse komunale të bëjnë asnjë ndryshim fizik në objektin sportiv.

Neni 7

Menaxhimi i financave

1. Menaxhim financiar nënkupton përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e objekteve sportive publike.
2. Tarifat për shfrytëzimin e objekteve sportive publike përcaktohen sipas kësaj rregulloreje.
3. Organizimet e parapara nga Komuna e Vitisë, nga institucionet e nivelit qendror të Republikës së Kosovës, lirohen prej obligimeve financiare. Organizatat e parapara në paragrafin 4, duhet të paguajnë edhe nga të hyrat, biletat, deri në masën 10 %.
4. Tarifat për shfrytëzimin e fushës sportive ndryshojnë sipas kategorive: aktivitete shkollore, klube sportive, shkollë sportive, grupe formale dhe joformale dhe ngjarje të veçanta sportive.

5. Tarifat për shfrytëzimin e fushës sportive ndryshojnë sipas kohës së shfrytëzimit: orëve, ditëve, stinëve dhe kushteve tjera të veçanta sipas rregullores për të hyra vetanake të Komunës së Vitisë.
6. Për organizatat sportive që nuk e kanë statusin e OJQ-së, obligohen t'i bëjnë pagesat konform rregullores për të hyra vetanake të Komunës.
7. Tarifa për shfrytëzimin e objekteve sportive publike, është paraparë të rregullohet me rregulloren e të hyrave vetanake të Komunës së Vitisë.

Neni 8

Mirëmbajtja

1. Përgjegjësit e objekteve sportive publike, obligohen të përgatisin një paramasë dhe parallogaritë për çdo intervenim të planifikuar dhe ta parashtrorjnë si kërkesë në DKRS për vitin e ardhshëm.
2. Pjesa e intervenimeve të vogla do të bëhet nga operatorët e kontraktuar nga Komuna e Vitisë.
3. DKRS e shqyrton kërkesën e parashtruar për intervenim në mirëmbajtje dhe të njëjtën e parashih në buxhet.
4. Investimet kapitale të nevojshme në objektin sportiv realizohen nga buxheti i Komunës së Vitisë si dhe donatorët.
5. Nevojat për investime përcaktohen nga DKRS dhe aprovohen nga kryetari i Komunës.

Neni 9

Procedurat për shfrytëzimin e objekteve sportive publike

1. Për aktivitete sportive dhe josportive, secili person fizik dhe juridik duhet të paraqesë kërkesë me shkrim 72 orë para aktivitetit në organin kompetent.
2. Të gjitha aktivitetet që organizohen nga DKRS-ja, Komuna e Vitisë, shoqatat e dalura nga lufta e UÇK-së dhe PAK-u (Personat me Aftësi të Kufizuara), lirohen nga të gjitha obligimet, por duhet të bëjnë njoftim me shkrim pranë organeve kompetente.
3. Organizatat të cilat obligohen të bëjnë pagesa sipas nenit 7, duhet të marrin formularin e fletëpagesës në organin kompetent të DKRS-së.
4. Pagesat realizohen nëpërmjet xhirollogarisë komunale dhe ato konsiderohen si të hyra vetanake.
5. Organizatat sportive dhe josportive, duhet të paraqesin një kërkesë zyrtare, planin e punës, lejen e njoftimit të personit përgjegjës dhe certifikatat e organizatës (regjistrimet fiskale), Ligjit për Sport.
6. Kërkesat shqyrtohen nga organi kompetent i DKRS-së dhe pas pranimit të kërkesës jepet përgjigjja në afatin ligjor sipas legjislacionit në fuqi.
7. Organi kompetent jep pëlqim për zhvillimin e aktiviteteve të tjera për të cilat nuk parashihet të nënshkruhet kontratë.
 - 7.1 Organi kompetent përpilon marrëveshja (kontratën), e cila duhet të nënshkruhet midis palëve, parashtruesit dhe shqyrtuesit për organizimet e parapara, për të cilat duhet të nënshkruhet kontratë.
8. Kontrata duhet të parashih obligimet dhe të drejtat e dy palëve si dhe lartësinë e përqindjes për zhvillimin e aktivitetit, e cila duhet të jete 30 % për DKRS-në dhe 70 % për palën kërkuuese.

Neni 10

E drejta e reklamimit

1. Te gjitha palët e interesuara kanë të drejtë të reklamojnë logot e firmave të tyre.
2. Palët e interesuara për reklamim, duhet të bëjnë marrëveshje me organin kompetent, respektivisht DKRS-në.
3. Për çmimoren e reklamës vendos Drejtoria për Urbanizëm pas kërkesës së bërë nga pala e interesuar.
 - 3.1 Pala e interesuar, paraprakisht duhet të marr pëlqim në organin kompetent të DKRS-së sipas legjislacionit në fuqi për vendosjen e reklamës në përputhje me kriteret e parapara me nenin 10 paragrafi 3.
4. Mediat e shkruara dhe ato elektronike, hyrjen në objekte sportive publike e kanë falas, përveç nëse organizatat sportive e parashohin ndryshe.
5. Subjekti që merr në shfrytëzim objektin sportiv, ka të drejtë të vendos hapësirat reklamuese ku zhvillon aktivitetin sportiv.
 - 5.1 Pas përfundimit të drejtës së shfrytëzimit të objektit sportiv, subjekti është i obliguar që objektin dhe hapësirën ta kthej në gjendjen e mëparshme.
 - 5.2 Hapësirat reklamuese nuk mund të shfrytëzohen në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik.

Neni 11

Lokalet në objektet sportive

1. Lokalet në objekte sportive jepen në shfrytëzim për palët e interesuara sipas ligjit në fuqi për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim. Nëse një gjë e tillë vlerësohet e favorshme pas pëlqimit për DKRS-në dhe Komunën e Vitisë.
 - 1.2 Lokalet sportive fillimisht jepen sipas prioriteteve, rezultateve, pjesëmarrjes në gara dhe garimit të rotacionit e barazisë për shoqatat, klubet, shkollat e sporteve të Komunës së Vitisë.
 - 1.3 Organizatat e lartcekura në piken 1.1 të këtij neni, hapësirat sportive s'mund t'i shfrytëzojë pa vendimin paraprak të DKRS-së.
 - 1.4 Lokalet sportive për organizata jashtë Komunës së Vitisë jepen vetëm në rast se ka hapësira të lira dhe me një pagesë të qirasë mujore.
2. Lokali duhet të veproje në përputhje të plotë me kushtet dhe kriteret e cekura në kontratën e nënshkruar pas zhvillimit të procedurave me Kryetarin e Komunës.

Neni 12

Rendi shtëpiak

1. Te gjithë shfrytëzuesit duhet ta respektojnë kodin e mirësjelljes, të miratuar nga DKRS-ja.
2. Për zyrtaret kompetentë të Komunës së Vitisë vlen Rregullorja e QRK-së, Nr.04/2015 për Kodin i Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Neni 13

Orari

1. Objekti sportiv është në funksion 7 ditë në javë, duke filluar nga ora 08:00-22:00.

2. Përfundimisht kur është duke u zhvilluar aktiviteti, orari vazhdon deri në momentin e përfundimit të aktivitetit.
3. Orari i punës për zyrtarët përgjegjës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimeve nga DKRS-ja për organizimin e orarit.
4. Oraret tjera që nuk janë paraparë me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të rezervohen me kërkesa të posaçme.
5. Orari i lokaleve që jepen në shfrytëzim, përcaktohet në përputhje me nenin 12.

Neni 14

Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara

1. Përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara e bart organizata nikoqire, e cila e organizon aktivitetin.
2. Për dëmin e bërë nga organizata nikoqire, DKRS-ja krijon komisionin prej tre anëtarësh, i njëri anëtar është qytetar nga nikoqiri dhe dy nga DKRS për vlerësimin e dëmit.
- 2.1 Qytetari anëtar i komisionit, caktohet nga DKRS-ja.

Neni 15

Masat ndëshkuese

1. Ndaj palëve të cilat nuk e respektojnë rregulloren, rendin shtëpiak dhe oraret, merren masa ndëshkuese, si:
 - 1.1 Vërejtje me gojë;
 - 1.2 Vërejtje me shkrim;
 - 1.3 pezullim të zhvillimit të aktiviteteve për një kohë të caktuar, 3, 6 ose 9 muaj;
 - 1.4 Përfundimisht të përherëshëm nga zhvillimi i aktiviteteve dhe hapja e procedurave – ligjore;
 - 1.5 Gjykojnë mandatore sipas legjislacionit në fuqi.
2. Për zbatimin e masave ndëshkuese formohet komisioni, i cili propozohet nga DKRS-ja, me vendim të kryetarit të Komunës. Ky komision formohet me mandat 2 vjeçar.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

1. DKRS-ja është e obliguar, që t'i pajisë me një kopje (fizike apo elektronike) të rregullores të gjitha palët që e shfrytëzojnë objektin sportiv publik.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e rregullores i bën vetëm Kuvendi i Komunës së Vitisë.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Vitisë dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Web-sajtit të Komunës së Vitisë.

Viti, 07 maj 2019

Propozuesi:


Kryetari i Komunës:

Sokol HALITI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Nga: Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Për: Kuvendin Komunal të Vitisë

Lënda: Informatë (raport) mbi punën e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në Statutin e Komunës së Vitisë, rregulloren e Kuvendit Komunal të Vitisë për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë, rregullorja nr.01-013/858 e datës 17.07.2012, ka formuar komisionin për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane me këtë përbërje: Basri Sylejmani, Avdi Rexhepi, Fatlum Demiri, Tefik Salihu. Ne si komision jemi takuar, nga i cili takim kemi përgatit njoftimin për procesin e fillimit të zgjedhjes së kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Njoftimi me datën 01.02.2019 është publikuar në web faqen e Komunës së Vitisë, kryetari i komunës, me datën 01.02.2019 ka ftuar në takim të gjithë kryetarët e fshatrave të cilët i ka falënderua për punën e bërë dhe të cilëve ju kemi dhënë nga një njoftim dhe kemi kërkuar nga ata që t'i njoftojnë të gjithë qytetarët e atyre lokaliteteve. Anëtar i komisionit Fatlum Demiri, me datën 05.02.2019 ka mbajtur një intervistë me Plus Televizionin, e cila intervistë u publiku nga i njëjti televizion përmes së cilës i kemi njoftu të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë për fillimin e këtij procesi.

Aktiviteti: Zgjedhja e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Takimet me qytetarë për zgjedhja e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, janë mbajtur sipas këtij orari:

Data e Takimi me qytetaret	Lokaliteti / Vendbanimi	Numri i pjesëmarrësve			Mënyra e votimit, Kryetari dhe anëtarët e këshillit
		M	F	Total	
19.02.2019	Viti	53	20	73	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetare e zgjedhur: znj.Xhilsime Qamili, nuk ka pasur kundërkandidat. - Anëtarët e këshillit të qytetit të Vitisë: Isa Hasani, Emine Salihu, Herolind Haxhiu, Kadri Aliu, Sadri Abazi, Selami Avdyli, Lirie Aliu, Otoneta Tahiri, Adifete Maliqi, Qemajl Neziri.
20.02.2019	Drobesh	59	4	63	- Mënyra e votimit: Votim i mbyllur - Kryetar i zgjedhur: z.Bislim Bislmi me 57 vota - Anëtarët e këshillit të fsh. Drobesh: Burim Berisha, Memetali Hajdini, Avni Peposhi, Armend Selmani, Fidan Jashari, Ejup Hajdini, Bekim Muja, Burim Qazimi
20.02.2019	Gërmovë	62	2	64	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetare i rizgjedhur: z.Vehbi Tahiti, nuk ka pasur kundërkandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh.Gërmovë: Isuf Bajrami, Blerim Lamallari, Ismet Ismajli, Fevzi Mema, Hesc Hasani, Bashkim Lamallari, Mejd Selimi, Edona Sylejmani, Dardan Sylejmani, Skender Sylejmani
21.02.2019	Goshicë	52	0	52	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetare i rizgjedhur: z.Muhal Zejnullahu, nuk ka pasur kundërkandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh. Goshicë: Bujar Metallari, Jahi Malic, Adhurim Bajrami, Avdyli Rashi, Ramush Bilalli, Sejdi Emini, Luq Islami, Kastriot Ademi, Arif Lima, Fetah Fetahu

21.02.2019	Smirë	71	1	72	• Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetare i zgjedhur: z.Tajar Hyseni, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Smirë: Jakup Demiri, Florent Ymeri, Nijazi Fejzullahu, Veton Ademi, Arton Elezi, Lirie Mustafa, Besnik Imeri, Granit Avdyli, Shefqet Shaqiri, Imri Sahiti.
22.02.2019	Buzovik	47	0	47	• Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetare i rizgjedhur: z.Mehmetali Shefkriu, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh. Buzovik: Shaban Rama, Emrush Baftiari, Murat Idrizi, Avdyl Rrahimi, Besart Idrizi, Sokol Mehmeti, Hajdin Bekteshi, Alban Qamili.
22.02.2019	Shushtë	25	0	25	• Mënyra e votimit: Votim i hapur dhe i mbyllur. • Kryetare i zgjedhur: z.Hamit Zenel me 13 vota kurse kundër kandidat z.Xhevat Zeneli 12 vota. • Anëtarët e këshillit të fsh. Shushtë Hasan Zeneli, Xhevat Zeneli, Driton Zeneli, Aziz Iseni, Hestet Mehmet Remzi Hyseni.
25.02.2019	Kabash	156	0	156	• Mënyra e votimit: Votim i mbyllur • Kryetare i zgjedhur: z.Arben Jakup me 106 vota kurse kundër kandida z.Fitim Hasani 43 vota. • Anëtarët e këshillit të fsh. Kabash Muhamet Azizi, Pal Feri, Shuk Misini, Ridvan Hasani, Shkelze Haliti, Sokol Selmani, Dodë Simoni Feriz Deliu, Zef, Marku, Beki Aliu.
26.02.2019	Tërpezë	96	0	96	• Mënyra e votimit: Votim i mbyllur • Kryetare i zgjedhur: z.Gazme Salihu me 48 vota, Skender Haz 33 vota dhe Agim Emini 15 vota. • Anëtarët e këshillit të fsh. Tërpe Enver Halimi, Agim Emini Vllaznim Isufi, Ukshin Ahmeti, E Halimi, Bekim Azizi, Flan

					Shaqiri, Selami Rexhepi, Zahir Tahiri, Skender Haziri.
26.02.2019	Qifllak	16	2	18	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetare u rizgjedhur: z.Ganimet Shabani, nuk ka pasur kundër kandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh. Qifllak: Vjollca Shabani, Rinor Jashari, Kadri Shabani, Herolind Shabani, Admir Shabani, Agron Shabani
27.02.2019	Radivojc	48	0	48	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetare i zgjedhur: z. Ymer Hyseni, nuk ka pasur kundër kandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh. Radivojc: Qemajl Misini, Jeton Zeqiri, Ibrahim Devaja, Flamur Ismaili, Ramadan Pajaziti, Burim Sylejmani, Enver Januzi, Kushtrim Beqiri, Fatlum Halili, Nijazi Salihu
27.02.2019	Devajë	27	0	27	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetare u rizgjedhur: z. Ili Rustemi, nuk ka pasur kundër kandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh. Devajë: Veton Bajrami, Qazim Beqir Liridon Uka, Selver SHalti, Lulzir Misini, Leutrim Bajrami
28.02.2019	Letnicë	24	0	24	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetare u rizgjedhur: z.Shin Gjoni, nuk ka pasur kundër kandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh. Letnicë: Vilson Ukaj, Vaid Alija, Seuda Sinani, Gjergj Nuqi, Fadil Gasli, Krist Leniciq
04.03.2019	Beguncë	65	0	65	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetare i zgjedhur: z.Nexhmed Haliti, nuk ka pasur kundër kandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh.Beguncë: Vetim Sylja, Raif Musliu, Bejtu Hyseni, Urim Haziri, Selami Aba Sami Tahiri, Avdi Bajrami, Agr Zeka, Qemajl Hyseni, Lirid Hasani.

05.03.2019	Verban	195	3	198	• Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. • Kryetarë u rizgjedhur: z.Afrim Ramushi me 127 vota, kundër kandidati Adem Jahiri 64 vota. • Anëtarët e këshillit të fsh.Verban: • Adem Jahiri, Bajram Sokoli, Naim Berisha, Hysni Rrahmani, Zahir Emerllahu, Isa Ramadani, Sherif Neziri, Muhamet Ukshini, Kemajl Bislimi, Naser Emini.
06.03.2019	Ballancë	40	1	41	• Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetar i zgjedhur: z. Valon Latifi, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Ballancë: • Bashkim Aliu, Skender Avdyli, Musli Neziri, Naser Aliu, Hyse Rama, Liridon Januzi, Hetem Kurteshi, Mubekir Veseli, Izjadin Maliqi, Burim Haliti.
06.03.2019	Zhiti	19	0	19	• Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar i zgjedhur: z. Burim Emini nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Zhiti: • Ali Pajaziti, Tajar Neziri, Kujtin Haziri, Remzi Rexhepi, Rrahin Ferati, Adnan Emini.
07.03.2019	Trestenik	39	0	39	• Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar u rizgjedhur: z.Isa Ibrahim, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Trestenik Xhevat Hyseni, Rejhan Ismajl Sheski Shesku, Zeqir Sadriu, Iz Sherifi, Ali Xhemajli, Ahm Ahmeti, Blerim Halili
08.03.2019	Skifteraj	90	7	97	• Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar i rizgjedhur: z.Demu Sadiku 62 vota, Ismet Islami 1 Mustaf Abazi 8 vota, Anëtarët këshillit të fsh. Skifteraj: Sha Ismajli, Valmir Sahiti, Beki Halimi, Faik Ramadani, Ri Sadiku, Selver Islami, Mustaf Aba Zeqir Rexhepi, Feriz Avdiu, Bek Shabani, Nijazi Lutfiu, Esh

					Sadiku, Ramadan Ademi, Ismet Islami
08.03.2019	Remnik	164	0	164	- Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. - Kryetar u zgjedh: z.Besim Rexhepi 68 vota, Përparim Avdiu 67 vota, Osman Mustafa 21 vota. - Anëtarët e këshillit të fsh. Remnik: Osman Mustafa, Xhevgjet Shabani, Ramadan Musliu, Riza Misini, Bajram Ibrahim, Ramadan Hasani, Ekrem Neziri, Mufail Hasani, Abedin Sejdiu, Nevzat Ibrahim, Agim Neziri, Ramush Aliu
11.03.2019	Lubishtë	60	0	60	- Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. - Kryetar u zgjedh: z.Vebi Xhymshiti me 36 vota, Skender Mala 24 vota. - Anëtarët e këshillit të fsh. Lubishtë: Selami Shema, Izet Ferizi, Ilir Metushi, Fejzë Islami, Sami Zeka, Haki Behluli, Isuf Hetemi, Pajazit Ismajli, Kadri Mehmeti.
11.03.2019	Mjak	40	3	43	- Mënyra e votimit: Votim i hapur. - Kryetar u rizgjedh: z.Muharrem Beqiri. - Anëtarët e këshillit të fsh. Mjak: Mala Beqiri, Xhemajl Lamallari, Fitore Beqiri, Ahmet Lamallari, Musa Ajvazi, Qllirim Metallari, Murat Lamallari, Xhezair Beqiri, Bleona Beqiri, Hajrush Mjaku.
12.03.2019	Pozharan	481	23	504	- Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. - Kryetar u zgjedh: z. Ilir Zuka me 256 vota, Elbasan Aliu 59 vota, Qamil Rexhepi 41 vota, Tasin Halabaku 61 vote dhe 1 vote e përvlefshme - Anëtarët e këshillit të fsh. Pozharan: Elbasan Aliu, Qamil Rexhepi, Makfirete Zuka, Diturie Ramiq, Baki Musa, Bukuriye Alidema, Mentor Demiri, Rasim Terziq, Kemajl Selimi, Majlind Ostërgllava, Fitore Alidema, Drit

					Pira.
13.03.2019	Potgorc	15	0	15	- Mënyra e votimit: Votim i hapur. - Kryetar u zgjedh: z.Naim Haziri nuk pat kundërkandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh.Potgorc: Agron Haziri, Gazmend Ymeri, Zeqir Avdiu, Isuf Rexhepi, Ardian Haziri, Agush Avdiu.
13.03.2019	Ramnishtë	32	0	32	- Mënyra e votimit: Votim i hapur. - Kryetar u zgjedh: z. Adem Shabiu nuk pat kundër kandidat. - Arbnor Ademi, Njazi Avdiu, Ilir Syla, Nasuf Abazi, Bekim Sylejmani, Hekrem Hasani, Hasan Ademi, Luran Demiri.
14.03.2019	Ramjan	112	5	117	- Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. - Kryetar u rizgjedh: z. Kadri Ismajli me 64 vota, Eror Hyseni 52 vota. - Anëtarët e këshillit të fsh.Ramjan: Hazbi Ismajli, Ekrem Zejnullahu, Liridon Emerllahu, Ridvan Emerllahu, Rafiz Ismajli, Sada Rexhepi, Makfir Zejnullahu, Nase Rexhepi, Hamdush Hyseni, Zeqi Hyseni
14.03.2019	Fshati i Ri	118	5	123	- Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. - Kryetar u zgjedh: z. Bajrush Zene me 78 vota, Perparim Sadiku 4 vota. - Anëtarët e këshillit të Fshatit të R: Përparim Sadiku, Arben Selman, Qendrim Hajrizi, Veton Ramadan, Florim Brahimi, Hamit Beqiri, Arben Shaqiri.
15.03.2019	Sllatinë e Epërme	450	74	524	- Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. - Kryetar u zgjedh: z.Daut Drugza me 233 vota, Ekrem Ymeri 20 vota, Isuf Qosa 36 vota. - Anëtarët e këshillit të fsh. Sllatinë Epërme: Ekrem Ymeri, Bed Ymeri, Dashnim Ymeri, Elbas:

					Ahmeti, Flamur Dauti, Irfan Rexhepi, Osman Lluleci, Idriz Ajvazi, Ismet Hoxha, Valzim Drugzani, Musli Qosa, Muhamet Arapi, Kushtrim Ajvazi, Bashkim Sefedini.
18.03.2019	Sadovinë e Jerlive	55	1	56	• Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetar u rizgjedh: z. Sefedin Fetahu • Anëtarët e këshillit të fsh. Sadovinë e Jerlive: Dianë Avdyli, Mentor Aylejmani, Bislim Shabani, Sabri Miftari, Rinor Imeri, Elham Fazliu, Faredin Selmani, Bekim Misini.
18.03.2019	Sadovinë e Çerkezëve	79	0	79	• Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. • Kryetar u zgjedh: z.Ermal Ismajli me 64 vota, Fatmir Islami 15 vota, • Anëtarët e këshillit të fsh. Sadovinë e Çerkezëve: Agim Xheladini, Rexhep Osmani, Premtim Bilalli, Qëndrim Hasani, Xhevdet Mehmeti, Bejtullah Musliu, Xhemajl Shabani, Gazmend Ismajli.
19.03.2019	Debellde	19	0	19	• Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar u zgjedh: z.Fazli Neziri. • Anëtarët e këshillit të fsh. Debellde: Mehmet Rrahmani, Selajdin Ismajli Fekir Ilazi, Zymri Azemi, Sabir Sylja, Halil Neziri.
19.03.2019	Goden i Madh	27	0	27	• Mënyra e votimit: Votim i mbyllur • Kryetar u zgjedh: z. Bajram Aziz me 17 vota, Nexhat Shaqiri 9. • Anëtarët e këshillit të fsh.Goden Madh: Përparim Hafizi, Rami Limani, Nexhat Shaqiri, Ekren Sahiti.
20.03.2019	Sllatinë e Poshtme	19	0	19	• Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar u zgjedh: z.Nerito Demelezi. Nuk pat kundërkandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Sllatinë Poshtme: Mafil Frangu, Ylbe Sylejmani, Zenel Frangu, Hal Lubishtani, Bejtulla Demelez Sheski Hajrullahu, Arber Frangu.

28.03.2019	Stubëll e Poshtme	0	0	0	
28.03.2019	Stubëll e Epërme	44	3	47	- Mënyra e votimit: Votim i hapur. - Kryetar u rizgjedh: z. Marjan Ramaj. Nuk pat kundërkandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh.Stubëll e Epërme: Kolë Ramaj, Gjergj Munishi, Ilir Ukaj, Luljana Toma, Elizhbeta Dodes, Jozef Ramaj, Luz Zefi, Agim Demaj, Lulzim Toma, Anton Gjergji.
29.03.2019	Budrikë	21	0	21	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetar u zgjedh: z.Arben Sahiti nuk pat kundërkandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh.Budrikë: Menderes Mehmeti, Muhamet Mustafa, Faton Sadiku, Ali Sadiku, Bekim Shabani, Fatmir Azizi, Ali Hasani, Zahir Jashari.
31.03.2019	Binçë	42	1	43	- Mënyra e votimit: Votim i hapur - Kryetar u zgjedh: z. Alia Toma nuk pat kundërkandidat. - Anëtarët e këshillit të fsh.Binçë: Agron Ferizi, Besart Marku, Bozha Stephani, Anton Simani, Samet Ilazi, Albert Gega, Viktor Steoani, Nikolina Marku.
Totali i pjesëmarrësve		2962	155	3117	
Përqindja:		95 %	5 %	100 %	

Gjate këtij procesi janë rizgjedhur **13 kryetar**, ndërsa kryetar të zgjedhur kemi **23**. Gjithashtu kemi edhe **1** kryetare të zgjedhur në qytetin e Vitisë. Gjithsej të zgjedhur kemi **36 kryetarë**.

Gjate këtij procesin janë zgjedhur **21 anëtare femra** të këshillave të fshatrave dhe **331 anëtar** të gjinisë mashkullore, ku gjithsej janë zgjedhur **352 anëtar** të këshillave të fshatrave. Nga kjo kuptojmë, që në këshilla të fshatit janë zgjedhur **5.96 %** të gjinisë femërore, përqindje e njëjtë me pjesëmarrjen e femrës në këtë proces.

Publikimi në media:

Takimet me qytetaret të gjitha këto aktivitete janë publikuar në faqen zyrtare të internetit: www.kk.rks-gov.net/viti dhe në facebook, Komuna e Vitisë, në çdo lokalitet ku janë mbajtur zgjedhjen.

Anëtarët e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

1. Fatlum Demiri- Kryetar i Komisionit




2. Avdi Rexhepi- Anëtar i Komisionit



3. Basri Sylejmani-Anëtar i Komisionit



4. Tefik Salihu- Anëtar i Komisionit



Informata (raporti) ju dërgohet

1. Kuvendit Komunal të Vitisë,
2. Arkivit.

Viti, Prill 2019



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Promat - Prometa 11-04-2019

12-016/01-380



Manifestimi "Flakadani i Karadakut"
edicioni XVIII
21-26 Mars 2019

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport /
Republika e Kosovës / Komuna e Vitisë





Republika e Kosovës

Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë

Municipality of Viti/Vitina

Drejtoria për Kulturë, Rinidhe Sport

Department of Culture, Youth and Sports



DATE/A:	Prill, 2019
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal, Viti
NGA/ZA/FROM:	Z. Milot LALA Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport
PËRMES/OD/FROM:	Zt. Naim PIRA Kryesuesi Kuvendit Komunal
C.C	Zt. Sokol HALITI Kryetari Komunës së Vitisë
LËNDA:	Informatë për Manifestimin "Flakadani i Karadakut" edicioni XVIII

Përmbajtja


I.	KËSHILLI ORGANIZATIV I MANIFESTIMIT.....	4
a)	Përbërja e Këshillit Organizativ.....	4
b)	Ndarja e detyrave të Trupës Koordinuese.....	5
II.	RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE.....	6-9
a)	Aktivite Kulturore dhe sportive.....	7-9
III.	RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT.....	10-11
a)	Tabela e kostos totale buxhetore.....	10
b)	Tabela e shpenzimeve për shërbime	11
c)	Tabela krahasuese (2018-2019) e shpenzimeve.....	11
IV.	MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT DHE MEDIAT.....	12

I. KËSHILLI ORGANIZATIV I MANIFESTIMIT

a) Përbërja e Këshillit Organizativ

1. Sokol Haliti - Kryetar i Komunës - Kryetar i Këshillit Organizativ
2. Hasan Aliu - anëtar
3. Naim pira - anëtar
4. Milot Lala - anëtar
5. Nexhmedin Jakupi - anëtar
6. Fatbardha Emini- anëtare
7. Kosovar Azemi - anëtar
8. Qahil Sinani - anëtar
9. Qemajl Rexhepi - anëtar
10. Avdyl Bajrami - anëtar
11. Agim Lipovica- anëtar
12. Ali Bajrami - anëtar
13. Mirlinda Sadiku - anëtare
14. Bekim Azizi - anëtar
15. Besim Ymeri -anëtar
16. Rasim Tërziu -anëtar
17. Ismet Sejdiu - anëtar
18. Emrush Azemi - anëtar
19. Muhabi Haxhiu - anëtar
20. Bejtush Qosa - anëtar
21. Agron Abazi - anëtar
22. Enver Osmani - anëtar
23. Adnan Zenuni- anëtar
24. Muhamet Maliqi - anëtar
25. Arianit Hetemi - anëtar

b) Ndarja e detyrave të Trupës koordinuese:



II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE

a) Aktivitet kulturore dhe sportive

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv "Flakadani i Karadakut 2019", organizimi dhe mbajtja e edicionit 18-të me radhë, si një nga ngjarjet më të mëdha kulturore në Komunën e Vitisë, ku tubon artistët dhe grupet artistike e të mbarë Kombit Shqiptar e me gjere.

Ky eveniment kulturore e sporti, u mbajt në sajë mbështetjes së projektit "Flakadani i Karadakut 2019", nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë Z. Sokol Haliti, dhe punës së palodhshme të Trupës Koordinuese.

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv "Flakadani i Karadakut 2019" ka filluar më 21 mars 2019, ku u bë hapja solemne e manifestimit me dhezjen e Flakadanit dhe ka përfunduar më 26 mars me mbrëmjen finale të Festivalit Mbarëkombëtar të Ansambleve dhe Shoqërive Kulturore dhe Artistike. Në këtë tubim pos udhëheqjes komunale dhe shoqatave të ndryshme prezantuan edhe mysafir të shumtë nga Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës, Maqedonia, Mali i zi dhe nga Diaspora shqiptare e cila jeton dhe vepron në Zvicër.

Aktivitetet Kulturore dhe sportive:

- o Garat regjionale të recituesve – u mbajtën në sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 22 Mars 2019 me fillim në ora 11.00. Në këto gara prezantuan nxënësit e shkollave të mesme të komunave: Preshevë, Bujanoc, Kaçanik, Kamenicë Gjilan, Viti dhe Ferizaj.

Juria profesionale e përbërë nga përfaqësuesit e komunave përkatëse, vlerësuan që vendi i parë t'i takoi Lidiona Marovca – SHM “Ismail Qemajli nga Kamenica me poezinë “Do të flas” kurse vendi i dytë iu nda Sajmir Maliqit - Gjimnazi “Skënderbeu” – Preshevë me poezinë “Abetaren time” ndërsa me vendin e tretë u shpërblye Majlinda Shehu – SHMP “ Feriz Guri dhe Vëllezrit Çaka ” nga Kaçaniku.

Për të gjitha shkollat pjesëmarrëse, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si organizatore e manifestimit, ndau falënderime.

- o Ora e Madhe Letrare – u mbajt në sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 23 mars 2019 me fillim në ora 14.00. Në Orën e Madhe Letrare prezantuan shkrimtarë, poetë nga të gjitha trevat shqiptare.

Juria profesionale në përbërje 3 anëtarëve me kryetar Agim Vinca, ka vlerësuar krijimet dhe poezitë më të mira të shkrimtarëve konkurrues të Orës së Madhe Letrare- “Flakadani i Karadakut 2019”.

Me çmimin e parë u nderua Prof . Dr. Isak Shema, çmimi i dytë i takoi Odise Plakut kurse çmimi i tretë u nda për poeten Vjollca Dibra

Nga ana e organizatorit, Çmimi për Vepër Jetësore iu nda Prof. Dr. Agim Vincës, kurse për kontribut të veçantë mirënjohje iu nda poetit Hyqmet Haskos nga Shqipëria.

- o Festivali Gjithëkombëtar i Shoqërive Kulturore e Artistike – u mbajt më 24, 25 dhe 26 Mars – prezantuan 15 -të Shoqëri Kulturore artistike nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Presheva dhe Zvicëra, kurse mysafir të mbrëmjes finale të festivalit Mbarëkombëtar të ansambleve dhe Shoqërive Kulturore dhe Artistike “Flakdani i Kardakut 2019” , ishin Solistet e mirënjohura nga estrada Shqiptare Merita Sahiti, Enkelejda Arif, Prena Beci dhe Fatojna Malsiu.

Mbrëmja e parë e festivalit, më 24 Mars:

Nr.	Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria Kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1	AKV "Kemajl Azizi"	Viti	Jashtë konkurrencës
2	SHKA "Teuta"	Zvicër	
3	AKV "Xheladin Zeqiri"	Tetovë	
4	A K V " Hasan Prishtina"	Vushtrri	
5	AKV "Ibe Palikuqi"	Shkup	

Mbrëmja e dytë e festivalit, më 25 Mars:

Nr.	Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1	SHKA "Jonuz Ramdani"	Smirë	Jashtë konkurrencës
2	Qendra Kulturore "Kaçaniku"	Kaçanik	
3	SHKA "Presheva Jehon"	Presheve	
4	SHKA "Koha - Dinoshë"	Tuz	
5	AKV "Dance Plus Folk"	Elbasan	

Mbërmja e tretë e festivalit, më 26 Mars

Nr.	Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	A K V B "Dasma"	Pozheran	Jashtë konkurrencës
2.	SHKA "Shotë Galica"	Drenas	
3.	AKV "Nakem"	Bursa	
4.	SHKA "Shamikuget"	Ferizaj	
5.	AKV "Bajram Shabani"	Kumanovë	

Juria profesionale në përbërje: Sami Piraj muzikolog, Dilaver Kryeziu koreograf dhe Minella Kureta mjeshtër i Madh, vlerësuan dhe ndanë 3 vendet e para dhe çmimin special të Festivalit Gjithëkombëtar të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore Flakdani i Karadakut 2019"

Vendin e parë iu nda AKV "Hasan Prishtina" nga Vushtrria, vendi i dytë AKV " bajram Shabani" nga Kumanova dhe vendi i tretë i takoi AKV " Xheladin Zeqiri" – Tetovë. Ndërsa me çmimin special u nderua AKV " Nakem" nga Bursa.

- Më 26 Mars, me fillim nga ora 10.00, u bënë homazhe dhe vendosja e kurorave me lule te varrezat e dëshmorëve – Dëshmorit Nijazi Azemi – Komandant Mjekrra.

Aktivitetet sportive:

- Turniri i madh në futboll të vogël
- Garat sportive në Shah
- Garat sportive të pingpongut

Ku të gjitha ndeshjet u zhvilluan gjatë rrjedhës së manifestimit Kulturor dhe Sportiv "Flakadani i Kardakut-2019.

III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT

a) Tabela e kostos buxhetore:

Tabela e shpenzimeve për shërbime:

Fondi burimor	Lloji i shpenzimit	Kostoja në €
Komuna e Vitisë/DKRS	Akomodimi	1,214.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Zërim	740.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Dreka (Shujta për grupet artistike dhe sportive)	9,770.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Rekulzita sportive	850.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Shtypja e materialeve grafike katalogje, cerada citillajda, rollop, postera, shtypja në bez e flamujve beza, gravura, fotografi etj.	2,170.00 €
Komuna e Vitisë /DKRS	Transmetimi idrejpërdrejt aktiviteteve te manifestimit "Flakadani I Karadakut 2019", nga Smart Media SH.P. K. (Plus TV)	1,376.00 €
Komuna e Vitisë /DKRS	Skenografia ndriçimi profesional	1,200.00 €
Totali:		17,320.00 €

Tabela krahasuese 2018 / 2019

"Flakadani i Karadakut 2018"	Flakadani i Karadakut 2019"
18,050.00 €	17,320.00 €

IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT

Mbështetësit: Komuna e Vitisë.

Mediat: Manifestimi Tradicional kulturor dhe sportive "Flakdani I karadakut 2019", u mbulua tërsisht nga "Plus Televizion", "Radio Televizioni i Kosoves", "TV 21", "TV T7", "TV Presheva", Zyra për Informim e Komunës së Vitisë, Radio Zëri i Pozheranit etj.

Viti, Prill 2019





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



NGA: DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

14.05.2019

PËR: Kuvendin Komunal në Viti

09-046/01-522

LËNDA: Informatë mbi përgatitjen për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të Komunës së Vitisë për sezonin verorë

Ju njoftojmë se për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të Komunës së Vitisë për sezonin verorë, e kemi të kontraktuar kompaninë "Zuka Commerce" nga Gjilani.

Kontrata është lidhur 01.08.2018 dhe i përfundon 31.07.2019, vlera e kontratës është 55,042.50 €.

Kompaninë e kemi njoftuar se duhet ti bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme për sezonin verorë, në mënyrë që të jetë sa më efikas në mirëmbajtjen verore të rrugëve lokale të Komunës së Vitisë dhe ofrimin e shërbimeve të duhura dhe me kohë.

Njëherit edhe kompania "Zuka Comerç" nga Gjilani, është zotuar se ka siguruar mekanizmin e nevojshëm për mirëmbajtjen e rrugëve dhe rehabilitimin e rrugëve të rendit të katërt, nëpër rrugët kryesore në vendëbanimet e Komunës së Vitisë dhe shërbimet e kërkuara do të kryhen me kohë dhe në mënyrë efikase.

Tani veç kemi filluar me mbushjen e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara si në fshatin Drøbesh dhe qytetin e Vitisë dhe kemi në plan edhe në disa fshatra për mbushjen e gropave me asfalt, sipas nevojës.

Kështu që lirisht mundë të themi se jemi të përgatitur mirë që shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen verore të rrugëve të kryhen me efikasitet dhe me kohë.

Informata i dorëzohet

1. Kuvendit Komunal – Viti
2. D.SH.P dhe E
3. Arkivit

Më: 13.05.2019, Viti

Drejtori:

/Nexhmedin Jakupi/





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

14-05-2019

01-016/01-523



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Nga: Kryesuesi i Kuvendit Komunalë të Vitisë

Për Kuvendin Komunal

Lënda: Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për periudhën janar- prill 2019

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunalë të Vitisë! Më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e komiteteve funksionale që janë të themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën janar- prill 2019.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, ka të themeluar komitete obligative dhe komitetet joobligative.

Komiteti për Politik dhe Financa është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv, i cili deri me sot ka mbajtur katër mbledhje.

Komiteti për Komunitete gjithë ashtu është komitet obligativ, i cili këtë vit ka mbajtur tri mbledhje.

Kuvendi Komunal i Vitisë ka të themeluar edhe komitetet konsultative funksionale si:

1. Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuar (ka mbajtur dy takime)
2. Komiteti për Pjesëmarrje të Qytetarëve në Vendimmarrje (ka mbajtur dy takime)

Përveç këtyre komiteteve kemi të themeluar edhe komitete të tjera si:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale;
2. Komiteti për Shërbime Publike;
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
4. Komiteti për Barazi Gjinore;
5. Komiteti për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mirëmbajtjen të Mjedisit.

Pothuajse të gjitha komitetet e cekura me lartë, joobligative nuk kanë qenë aktive.

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Pira

